
GJYLTEKIN SHEHU – LAUREATI QË SFIDOI FIGURËN E HUMANISTIT “HENRY DUNANT”

MIRLINDA SHEHU & LENDITA GJIKOLLI
Prishtinë, KOSOVA
mirlindashehu2@yahoo.com

AKTET V, 4: 705 - 708, 2012

PERMBLEDHJE

Duke marrë si shkas laurimin me çmimin ‘Prix Henry Dunant’ (të dorëzuar më 4 nëntor 1999) të Shoqatës “Henry Dunant” të Gjenevës, në artikull i bëjmë një prezantim personalitetit të profesor dr. Gjyltekin Shehut (1937-2010). Ishte profesor shumëvjeçar në Universitetin e Prishtinës, njohës dhe studiues i marrëdhënieve shqiptare frënge, përkthyes i letërsisë dhe i kulturës frënge në shqip. Është njëri prej humanistëve dhe kontribuesve të rëndësishëm në afirmimin e çështjes shqiptare e të çështjes së integritit të shqiptarëve në vendet evropiane, sidomos i afirmimit të çështjes së Kosovës në vendet frankofone. Me çka radhitet midis personaliteteve të shquara shqiptare e botërore për humanizëm.

1. Pak biografi

Prof. dr. Gjyltekin Shehu, është i lindur (24 maj 1937) në Nesalcë, fshat në afërsi të Bujanocit të Luginës së Preshevës (Serbi). Rrjedh nga një familje e njohur intelektuale e brumosur me ndjenja patriotike, humane e liridashëse. Shkollën fillore e mbaron në vendlindje, të mesmen pjesërisht në Kumanovë, pjesërisht në Gjakovë e në Prishtinë.

Ndërkaq, studimet universitare për gjuhët Romane i mori në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Shkupit (Maqedoni), ku u lauria midis studentëve më të mirë të gjeneratës. Studimet pasuniversitare i ndjek në Zagreb të Kroacisë dhe në Paris të Francës. Më 13 qershor 1966 u certifikua për fonetikë në Sorbonë – Paris. Pas pesë vjetëve, më 1971, përfundon studimet pasuniversitare, në fushën e letërsisë krahasimtare në Zagreb, duke mbrojtur me sukses temën e magistraturës me titull: “Egzotizmi në novelat e Prosper Merimesë dhe ngjashmëri të konsiderueshme tematike me letërsinë shqipe” (“Egzotizam u novelama Prospera Merimea i izvjesne tematske sličnosti u

albanskoj književnosti”) të udhëhequr nga prof. dr Artun Polansçak.

Më 1978, nën udhëheqjen e profesorit me famë botërore, Prince Charles Dédéyan, në Paris – Sorbonne IV mbron disertacionin me titull: “*La Corse et l’Albanie vues de l’aspect historique, littéraire et folklorique dans les lettres françaises du XIX^e siècle*” (‘Korsika dhe Shqipëria në letërsinë frënge të shek. XIX vrojtuar në aspektin historik, letrar e folklorik’).

2. Në shërbim të çështjes kombëtare

Deri më 1972, kur punësohet në Universitetin e Prishtinës punoi në vendlindje si mësues i frëngjishtes. Pas vendosjes në Prishtinë punoi si referent për Arsim dhe Kulturë, mandej si profesor i gjuhës latine në Lyceun e Prishtinës dhe, në fund, si zëvendës drejtor i Arkivit të Kosovës (1969-72). Një periudhë të gjatë, për një deçenie, ishte udhëheqës i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Frënge të Fakultetit të Filologjisë në Prishtinë.

Në dy deçeniet e fundit të shekullit të kaluar dhe në deçenien e parë të këtij shekulli vazhdimisht ishte në lëvizje. Ishte anëtar i shumë

asociacioneve dhe shoqatave kombëtare dhe ndërkombëtare, si: Institutit Sud – Est Européens à Bucarest – Rumani, Shoqatës “Henry Dunant” në Gjenevë, Shoqatës Internacionale të Doktorëve të Letërsisë të Universitetit të Parisit dhe të Universiteteve të tjera në Francë (AIDLUPA).

Duke u përfshirë në rrjedhat e jetës shoqërore të shqiptarëve të Kosovës dhe si njohës i mirë i shumë gjuhëve (greqishtes së vjetër, latinishtes, gjuhëve romane e sllave) dha një kontribut të rëndësishëm e të çmueshëm për themelimin e shoqatave të ndryshme, si shoqatës bamirëse “Nënë Tereza” (1990), po ashtu themeloi “Shoqatës Henry Dunant” për Kosovën (1992). Si njëri prej intelektualëve të shquar, në periudhën e paktimit kombëtar, midis të mërguarve në Gjermani e Suedi do të mbajë leksione, në të cilat angazhohet për afirmimin e nevojës së paktimit të gjaqeve.

Anëtarësimi në shoqata të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare i mundësoi të jetë në ballë të përpjekjeve të shqiptarëve të jashtëkufirit shtetëror për aktualizimin e statusit dhe të çështjes së tyre kombëtare, duke propaganduar dhe afirmuar këtë ide kudo që mori pjesë nëpër manifestime të Shoqatës Humanitare “Henry Dunant”: në Gjenevë apo Paris, Cannes apo Heiden, Culoz ose Solferino.

Për këtë veprimtari të madhe njerëzore me **4 nëntor 1999** i dorëzohet çmimi **“Prix Henry Dunant”** nga Zonja Pierrette Mourgue d’Algue. Me këtë rast zoti Roger Duran, kryetar i “Shoqatës Henry Dunant”, do të theksojë: “Është inkurajuese të zbulohen ata që, përveç tjerash, gjejnë energji ta luftojnë padrejtësinë. Mu në këtë drejtim sot, kemi nderin t’i shënojmë meritat e Profesor Shehut”.

Prof. dr Gjyltekin Shehu duke vazhduar pa u lodhur në veprimtarinë e tij humanitare dhe duke u angazhuar me gjithë qenien e tij biologjike e shpirtërore, gjashtë vjet më vonë, më 8 shtator të vitit 2005, me pëlqimin e përfaqësuesve të komunës së Prishtinës, të banorëve të lagjes Ulpiana, si dhe me ndihmën e Qeverisë Zvicrane e të Shoqatës “Henry Dunant” të Gjenevës, zbuloi bustin e humanistit zvicran “Henry Dunant”,

emrin e të cilit do ta mbajë njëra prej rrugëve në qendër të Prishtinës. Me çka dëshmohet se edhe Kosova bën pjesë në vendet ku mbisundojnë paqja dhe humaniteti.

Në ceremoninë e hapjes së këtij akti solemn, kryetarit të Shoqatës “Henry Dunant” në Prishtinë, prof. dr Gjyltekin Shehut, i erdhën shumë telegrame e letra urimi, në të cilat i shprehen falënderime Kosovës, qytetit të Prishtinës, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Shoqatës Henry Dunant të Kosovës, si dhe të gjithë personaliteteve që ndihmuan realizimin e këtij projekti në Ulpianë, në këtë lagje të bukur afër Universitetit të Prishtinës. Telegramet e letra përgëzimi Shoqatës i erdhën jo vetëm nga shoqata mëmë “Henry Dunant” e Gjenevës e Shoqata “Geneve, un lieu pour la paix”, por edhe nga Qeveria Federale e Zvicrës.

Në letrën e ministreshës së Punëve të Jashtme të Zvicrës, zonjës Micheline Galmyre, midis tjerash thuhet se kënaqësia e saj e veçantë është “ta përcjellë përkrahjen e Republikës së Gjenevës e të Kantonit të Gjenevës, të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq e të Gjysmëhënës së Kuqe, të cilët jo vetëm që e inkurajuan këtë iniciativë, por e sollën bustin e humanistit Henry Dunant nga Gjeneva në Prishtinë”.

Profesor dr Gjyltekin Shehu ndërroi jetë me 16 tetor 2010 në Prishtinë. Vdekja e tij u shënua me mbledhjen komomorative të organizuar në Fakultetin e Filologjisë. Letra ngushëllimi familjes i erdhën nga shoqata e personalitete të shquara nga vendi dhe bota. Midis tyre po përmendim: Shoqatën Henry Dunant të Gjenevës, të Francës, filantropin austriak Gerhard Voltz, humanistët Christine Dunant, François Mujac dhe shumë miq të tjerë.

Vdekja e parakohshme ia ndërpreu hovin e veprimtarisë humanitare, atdhetare, por edhe ndërprerjen e deakumulimit shkencor. Kështu, i mbetën në dorëshkrim shumë studime, të cilat shpresojmë një ditë do të botohen për vlerat shkencore dhe rëndësinë historike e kulturore që kanë.

3. Veprimtaria kërkimore shkencore

Profesor Gjyltekin Shehu ka një veprimtari të begatshme botuese, të cilat janë të karakterit shkencor, si tema (e magjistraturës dhe e doktoratit), projekti i dokumenteve franceze si dhe një numër i madh (mbi 100) studime të botuar në revistat shkencore dhe në periodikun shqiptar e të huaj. Pjesën më të madhe e përbëjnë artikujt e botuar nëpër pëmbledhjet e konferencave të ndryshme shkencore, si në Kosovë e në trojet e tjera shqiptare, ashtu edhe jashtë vendit, sidomos në Francë, si në Prishtinë, Shkup, Tiranë, Beograd, Zagreb, Cetinjë, Paris e Gjenevë. Shkroi artikuj kulturorë, libra mësimore të gjuhës frenge (për shkolla filllore e të mesme), u mor me përkthime (të letërsisë artistike dhe të dokumenteve historike) dhe mbi të gjitha botoi studime të fushave të ndryshme të shkencës gjuhësore, historike, antropologjike, etnografike, kulturore.

Midis studimeve më të rëndësishme monografike janë tema e magjistraturës dhe tema e doktoratës, pjesë të të cilave janë botuar në periodikun shqiptar e të huaj. Në punimin e magjistraturës *“Ekzotizmi në novelat e Prosper Merimesë dhe ngjashmëri të konsiderueshme tematike në letërsinë shqipe”* vuri në pah afritë dhe përkimet etno – psikologjike, shqiptaro – mediterane. E veçantja e këtij studimi është se konstatimet e veta prof. Gjyltekin Shehu, i mbështetë, përveç në literaturën shkencore edhe në hulumtimet personale në terren, që i kishte bërë gjatë qëndrimit të tij në Korfikë.

Në punimin e doktoratës *“Korsika dhe Shqipëria në letërsinë frenge të shek. XIX vrojtuar në aspektin historik, letrar e folklorik”* është tema bazë korfikë – shqiptare, e njohur dhe e shtruar që në magjistraturë, por tani shumë e shtrirë e sheshuar në gjerësi dhe e thelluar në hulumtimin e afrive etnopsikologjike, etnokulturore dhe historike, gjithnjë duke pasur pikënisje përkimet e traditës zakonore, siç janë: fjala e nderit apo besa e dhënë (La parole d’honneur), hakmarrja, tradita (la vendetta – la vengeance).

Duke qenë bursist shumëvjeçar i qeverisë franceze me sukses realizoi projektin historik shkencor *“Lidhja Shqiptare e Prizrenit në*

Dokumente Diplomatike Françeze (1878 – 1881)” (botuar më 2010). Në këtë përmbledhje dokumentesh të diplomacisë franceze punoi me një përkushtim të madh në deshifrimin, zgjedhjen, seleksionimin dhe sjelljen e tyre në shqip, që të jenë pronë e çdo lexuesi shqiptar dhe të huaj. Në të lexuesi dhe studiuesi do të njihet me qëndrimin e kësaj diplomacie ndaj shqiptarëve të njërës ndër periudhat më të lavdishme të historisë së tyre, të periudhës së fundit të shekullit të 19 – të.

Krijimtarinë e tij të tërësishme mund ta ndajmë në katër fusha:

- (a) kulturore;
- (b) librare;
- (c) përkthimore;
- (ç) shkencore.

4. Përfundim

Kontributi i prof. dr Gjyltekin Shehut është i rëndësishëm si në aspektin pedagogjik, e hulumtues shkencor, ashtu edhe në aspektin kombëtar dhe humanitar. Ai jetoi në momentet më të vështira në të cilën kalonte Kosova dhe ky krah i popullit shqiptar përgjatë shekullit të 20 – të, u ngjiz me të, agjitoi për të dhe duke e problematizuar çështjen shqiptare ndihmoi që ajo të bëhet pjesë përbërëse dhe e pashmangshme e agjendave më të avancuara diplomatike, jo vetëm nëpër konferenca shkencore e në tubime humanitare, por edhe në kontakt me gazetarë. Mbetet midis figurave më të rëndësishme kulturore e shkencore të kohës së re të Kosovës dhe të shqiptarëve.

Bibliografia e zgjedhur e prof. dr Gjyltekin Shehut:

(a) Shkrime kulturore

HISTORIA e Kryqit të Kuq 1997,
HISTORIA e Sindikatës së Kosovës;
NJË KUJTIM nga Solferino, 1995.
PIERRE Boisser “Henry Dunant”
GJURMËVE të humanistit të madh “Henry Dunant”, Prishtinë 2009.

(b) Libra shkollorë

GJUHA frënge për klasën e tretë gjimnaz me koautorë Sh.Sejdiu 1968.

GJUHA frënge për klasë të gjashtë të shkollës fillore, Prishtinë 1972.

GJUHA frënge për klasë të katërt gjimnaz Prishtinë 1983.

(c) Përkthime

Antoin de SAINT EXUPÉRY, *Princi i vogël*, Prishtinë 1965.

Prosper MERIMÉES, *Colomba: 'Stremljenje'*, serbo-kroatisht, Prishtinë 1973, nr. 1.

Pierre GUIRAUD: *Stilistika*, Prishtinë 1997.

(ç) Studime dhe artikuj

AUTOKTONIA shqiptare në Kosovë për këndin verilindor: Preshevë, Bujanovc, Vranjë, Leskoc, Surdulicë dhe Pçinjë: *Shkëndija*, Prishtinë prill, 1994.

CHANTS Populaires Serbes recueillies par Vuk Karaxhiç et leur echo en France: *BULLETIN D'XXXIV CONGRES D'ASSOCIATION DES Folkloristes Yougoslve*, Tuzla 1987.

CLAUDE Fauriel et la poesie Populaires Balcanique: *Cinquieme congres d'Etudes Sud-Est*, Beograd, 1984.

DIPLOMACIA franceze prej 1900- 1912 dhe çështja shqiptare: *Shkëndija* I, II, III, Prishtinë 1992/3.

DISA ngjashmëri tematike në shkrimet frënge dhe shqiptare Vendetta korzikane dhe shqiptare, *Çështje të studimeve albanologjike*, Prishtinë 1987, II, fq.377-390.

DISA pretendent për fronin e Shqipërisë (1912), Prishtinë 1997.

DISA të dhëna frënge mbi shqiptarët (sh.XIII-XVI), *Vjetari i Arkivit të Kosovës*.

DISA të dhëna statistikore përkitazi me numrin e banorëve në vilajetet e banuara me shqiptarë të Rumelisë më 1905: *Vjetari i Arkivit të Kosovës*, Prishtinë 1984 nr, 18-19.

EKZOTIZMI në veprën e Merimées: *Studia Philologica*, Prishtinë 1986.

GJUHA onomastike shqiptare në Korzikë: *Fjala*, Prishtinë, mars 1973.

HAKMARRJA korzikane dhe Shqiptare: *Kërkime albanologjike*, Prishtinë 1987.

KONGRESI i Manastirit në dokumentet diplomatike frënge: *Shkëndija*, Prishtinë 11.IV.1990.

KRYENGRITJA shqiptare në Vrajë dhe në Kosovën Veri-Lindore, *Sesioni I tetë shkencor, Shqiptarët gjatë viteve 1878-1948*, Shkup 26 korrik 2009, Prizren 2010.

KUFIJ greko – shqiptar 1913: *Fjala Jonë*, 1998 (Fejton).

LA BATAILLE de Kosova dans certains écrits français (1389): *Përparimi*, Prishtinë 1989, nr. 4.

LA TOPONIME balcanique dans la Chanson de Roland: *Sixieme Congres International d'Etudes du Sud- Est Europeen*, Sofia 1989.

LE CHANTS funébres corses, albanais et méditerranéens: *Bulletins du 33^{ème} Congrès des folklorists Yougoslaves à Rožaja (Monténégro)*, .

LES ALBANAIS dans les Orientales de Victor Hugo: *Journée de Victor Hugo*, l'Institut Français de Zagreb, Zagreb 1985.

LES PROTOCOLS de Florence: *Zëri (Voix)*, revue hebdomadaire en albanais, publiée comme feuillet en , Prishtinë, mars, avril 1998.

LIDHJA Shqiptare e Prizrenit në Dokumentet Diplomatike Franceze (1878-1881), Prishtinë 2010.

LIDHJA e Prizrenit, sipas dokumenteve të Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës , Prishtinë 1978.

PASHALLAKU i Prizrenit,, sipas memoareve të Emil Wiëttit: *Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike*, Prishtinë 1981, nr.10.

POPULLI shqiptar, viktimë e aspiratave ballkanike: *Fjala Jonë*, 1998.

PROSPER Merimée and Poetry of the Balcan People: *Callegium Antropological and Etnological*, Zagreb 1988.

PROSPER Merimée dhe foklori shqiptar: *Studia philologica*, Prishtinë 1982, 1-2.

QUELQUES Similitudes entre les Chantes funebres Corces et Albanais: XXXV CONGRES DE ASSOCIATION DES FOLKLORISTES YUGOSLAVES, Titograd 1988.

UDHËTARËT Francezë në Shqipëri: *Fjala*, Prishtinë 1979, pjesa II.

UDHËTARËT Francezë në Shqipëri: *Vjetari i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 1974. Pjesa e I.*